

AUDITIMI

ETIKA PROFESIONALE



Tetor 2012

Përmbajtja:

- Parimet themelore të etikës profesionale
- Pranimi i angazhimeve të auditimit
- Letrat e angazhimeve për auditim



Parimet themelore të etikës profesionale

Parimet
themelore

Kërcënimet

Mbrojtjet



Parimet themelore të etikës profesionale

- **Integriteti** – i drejtë dhe i sinqertë
- **Objektiviteti** – mënjanimi i anësisë, konfliktit të interesit dhe ndikimit të paligjshëm
- **Kompetenca profesionale dhe kujdesi** – kujdes, kompetenc, mbajtja e nivelit, ngritja dhe freskimi
- **Besueshmëria/Konfidencialiteti** – nuk duhet të shpalosen të dhëna përveç nëse kërkohen nga e drejta dhe detyra profesionale
- **Sjellja profesionale** – pajtueshmëria me ligjet dhe shmangia e çdo veprimi që e diskrediton profesionin



Standardet teknike

Kontabilisti duhet ti zbatojë shërbimet profesionale me kujdes dhe shkathtësi si dhe në pajtim me standardet relevante teknike dhe profesionale. Ai duhet tu përmbahet standardeve profesionale të shpallura nga:

- Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC);
- Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB);
- Shoqata së cilës i takon ose ndonjë trupë tjetër ligjëvënës; dhe
 - Ligjeve në fuqi.



Integriteti, Objektiviteti dhe Pavarësia

- Pavarësi në mendje dhe dukje – e domosdoshme për shprehjen e opinionit
- I pavarur – nga menaxhmenti
- Objektiv – pamja e vërtet/sinqert e p.f.
- Interesi publik – mbrojtja ma e sigurt



Kërcënimet për objektivitet, integritet dhe pavarësi

Kërcënimet rrjedhin nga:

- Interesi personal
- Rishikimi i vetvetës
- Përkrahja
- Familjariteti
- Frikësimet



Mbrojtja e interesit personal

Kërcënimet:

- Interesi financiarë
- Marëdhënjet e afërta biznesore
- Punësimi me klientin për siguri
- Partner në bordin e klientit
- Marëdhënjet familjare ose personale
- Dhurata dhe mikpritja
- Huatë dhe garancitë
- Pagesat e vonuara të tarifave
- % ose tarifatat kontigjente
- % e lartë e tarifave
- Dhënja e çmimeve shumë të ulëta
- Punësimi/Rekrutimi



Mbrojtja e interesit personal

Masat mbrojtëse:

- Heqja dorë nga interesi
- Largimi i individit nga ekipi nëse kërkohet një gjë e tillë
- Informimi i komitetit të auditimit të klientit për situatën në fjalë
- Përdorimi i një partneri të pavarur për të shikuar punën e kryer në rastë se kjo është e domosdoshme.



Krcënimi i vetë-rishikimeve

Kërcënimet:

- Shërbimet e fundit për klientin e sigurisë
- Shërbime të tjera të përgjithshme
- Përgatitja e regjistrave kontabël dhe p.fin.
- Shërbimet e vlerësimit
- Shërbimet e tatimit
- Shërbimet e auditimit të brendshëm
- Financa e korporatave
- Shërbime tjera



Kërcënimi i mbrojtjes- përkrahja

- Firma që jep shërbime sigurie promovon një pozicion ose opinion të tillë që kompromiton objektivitetin në të ardhmen.
- Veprimi si një avokat për klientin
 - Në gjygj, ose
 - Në mosmarrëveshje me palët e treta
- Reklamimi i aksioneve të një klienti të regjistruar në bursë

Masat mbrojtëse:

Përdorimi i departamenteve në firmë për të dhënë shpjegime te Komiteti i Auditimit

- Tërheqja prej angazhimit



Kërcënimi i familjaritetit

- Humbja e skepticizmit profesional
- Mbrojtja e interesit vetiak

Kodi i etikës profesionale kërkon:

- Qarkullimin e partnerëve në angazhim pas një periudhe të paracaktuar (5 v.)
- Qarkullimin e partnerëve tjerë pas 7 vj. Kthimi pas 2 v.
- Rishikimi i kontrollit të cilësisë në angazhime të qarkullojë midis partnerëve pas 7 v. kthimi pas 2.v.



Kërcënimi prej frikësimeve

- Fitojnë rëndësinë atëherë kur firma që ofron shërbime sigurie ka diçka që mundë ta humbë

Psh.

- Kërcënimi i klientit se do ta hedhë në gjyq për punët e bëra më parë

Përfitimet?

- Humbja e klientit
- Publiciteti negativ
- Zbulim i pakujdesive në punë
- Implikime të mëtejshme



Kërcënimi prej frikësimeve

Zgjidhja:

Shmangia e ngjarjes në situata të tilla

Nëse ngjanë, mbani parasysh:

- Materialitetin e çështjes gjyqësore
- Natyrën e angazhimit për shërbime sigurie
- Faktin nëse çështja gjyqësore ka të bëjë me angazhime të mëparshme për shërbime sigurie

Masat mbrojtëse:

- Dhënja e shpjegimeve ndaj KA rreth natyrës dhe shtrirjes së Ç.GJ.
- Largimi i individëve specifik të prekur prej ekipit të angazhimit
- Përfshirja e një kontabilisti shtesë për të rishikuar punën
- Nëse çështja është shumë serioze – tërheqja nga angazhimi për shkak të kërcnimit ndaj pavarësisë shumë të madhe.



Çështjet që ngjallin diskutime

- Shërbimet e shumëfishta
- Pazari për opinione
- Konfliktet e interesit

“Muri Kinez”



Pranimi i punëve të auditimit

- Reklamimi-tenderimi dhe marrja e punëve
 - Mos ta diskreditoj anetarin
 - Mos ti diskreditoj shërbimet e tjerë
 - Mos të jeni qorijentuese
 - Te mos përmbushin kërkesat ligjore-rregullative
- Negociatat e tarifave dhe dhënja e çmimeve shumë të ulëta – Auditorët duhet të jeni të sigurt se ofrojnë cilësi për çmimin e kërkuar
 - Në tendera zakonisht kërkohet:
 - Niveli i ekspertizës; Kompanitë e ngjashme të audituara; Prania kombëtare/nderkombëtare; dhe Tarifat e propozuara
- Etika në angazhim
 - Kualifikimi profesional i duhur; burimet ekzistuese janë të mjaftueshme; përfitoni referencat; komunikimi me auditorët aktual
- Miratimi
Leterangazhimi



Letërangazhimi

Duhet të konfirmon pranimin e emërimin dhe përgjegjësit e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje.

Përkufizon qartazi:

- Shtrirjen e përgjegjësive të auditorit,
- Konfirmimin e shkurtër për pranimin e klientit



Letërangazhimi

1. Objektivi i auditimit
2. Pergjegjesia e menaxhmentit
3. Korniza e zbatueshme e auditimit
4. Objekti i auditimit (IFAC)
5. Natyra e testeve dhe kufizimet
6. Qasja e pakufizuar
7. Konfidencialiteti
 - a) planifikimi
 - b) konfirmimet e shkruara – deklaratat
 - c) raportet tjera
 - d) tarifat



Letërangazhimi

- Përfshirja e auditorëve dhe ekspertëve të tjerë
- Përfshirja e auditorëve intern
- Marëveshja me auditorët e mëparshëm
- Kufizimet për sa i takon detyrimeve të auditorit
- Referencat ndaj të gjitha marëveshjeve të mëtejshme midis auditorit dhe klientit.



Titulli i kompanisë

Data: _____

Këshillit të drejtorëve:

Keni kërkuar që të bëjmë auditimin e bilancit të gjendjes të kompanisë DDD të datës 31 Dhjetor 19XX, si dhe pasqyrat gjegjëse të të hyrave dhe të rrjedhës së parasë. Ju informojmë se me kënaqësi e pranojmë angazhimin. Synim i auditimit tonë do të jetë prezentimi i mendimit tonë mbi pasqyrat financiare.

Auditimin do ta kryejmë më pajtim me SNA-të (*ose standardet gjegjëse kombëtare*) Këto standarde kërkojnë planifikim dhe zbatim të auditimit duke ofruar një bindje të arsyeshme se pasqyrat financiare janë të pastra nga gabimet materiale. Gjatë auditimit do të bëhet kontrollimi i provave me anë të testeve, i vlerave dhe shpalosjeve nga pasqyrat financiare. Gjithashtu do të bëhet edhe vlerësimi i parimeve të kontabilitetit si dhe vlerësimeve të menaxhmentit gjatë përpilimit të pasqyrave financiare, si dhe prezentimin e pasqyrave financiare në përgjithësi

Duke pasur parasysh karakterin testues dhe kufizimet e auditimit, së bashku me kufizimet tjera përcejlëse si të sistemit të kontabilitetit ashtu edhe atij të kontrollit intern, nuk përjashtohet mundësia që ndonjë gabim material të mbetet i pazbuluar.

Si shtojcë raportit tonë mbi pasqyrat financiare, parashikojmë ta bëjmë një përpilim të veçantë në të cilën do të përshkruajmë mangësitë e mundshme materiale në sistemin e kontabilitetit dhe atë të kontrollit intern.

Ju përkujtojmë se përgjegjësia për përpilimin e pasqyrave financiare duke përfshirë shpalosjet e nevojshme, bie mbi menaxhmentin e kompanisë. Kjo nënkupton edhe mbajtjen e shënimeve të kontabilitetit dhe të kontrollit intern, përzgjedhjen dhe aplikimin e parimeve të kontabilitetit, si dhe kujdesin mbi mjetet e kompanisë. Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, nga menaxhmenti do të kërkojmë dakordimin me shkrim, në përmbushjen e kërkesave tona për prezentimet e tyre që kanë të bëjnë me auditimin.

Presim një bashkëpunim të plotë nga personeli i juaj. Besojmë se do të na mundësojnë që të kemi në dispozicion çfarëdo shënimi, dokumenti dhe informatë tjetër të nevojshme për auditimin. Tarifat për shërbimet tona, të cilat do të faturojmë në varshmëri me përparimin e angazhimin, bazohen nevojat kohore për personat e caktuar në angazhim, plus shpenzimet e tyre afariste të përditshme. Kompenzimet për orë pune dallojnë në varshmëri të përvojës, aftësive dhe nivelit të përgjegjësisë së kësaj.

Kjo ofertë do të vazhdojë edhe për periudhat vijuese, përpos nëse ndërkohë nuk shkëputet, korigjohet apo zëvendësohet. Lutemi që një kopje të nënshkruar të na e ktheni si miratim të ujdisë për angazhimin tonë në auditimin e pasqyrave financiare.

Firma audituese



Ushtrimi 3

